



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

| | |
|----------|--|
| Data | |
| Nr. Prot | |

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
PËR
“MIRATIMIN E ORARIT TË VOTIMIT, NË ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR
NË BASHKINË HIMARË, TË DATËS 4 GUSHT 2024”

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Neni 11, pika 1 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon orarin e votimi për ditën e zgjedhjeve.

Neni 20, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ka parashikuar kompetencën e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projektaktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, për rregullat e detajuara për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve, detyrat e administratës zgjedhore dhe procedurat që zbatohen në zgjedhje.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Sikundër referon Kodi Zgjedhor, orari gjatë të cilit hapen qendrat e votimit i referohet periudha zgjedhore, konkretisht 15 Prill – 15 Maj, dhe 15 Tetor – 15 Nëntor. Duke qenë se zgjedhjet e datës 4 Gusht 2024, nuk përkojnë në asnjë prej periudhave zgjedhore të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, kërkohet që të përcaktohet nga Komisioni Rregullator se në cilën orë do të hapen dhe mbyllen qendrat e votimit.

Në zbatim të detyrimeve të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në këtë projektvendim parashikohet që qendrat e votimit të hapen në orën 7:00 dhe mbyllen në orën 19:00.

Për sa më sipër në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i propozon Komisionit Rregullator për shqyrtim dhe miratim projektvendimin “Për miratimin e orarit të votimit, në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 Gusht 2024”.

Sekretar i Përgjithshëm

(në mungesë dhe me urdhër)

Majlinda ÇELMETA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI RREGULLATOR

Data: __.__.2024

Nr:

Ora: __:__

VENDIM

PËR

**MIRATIMIN E ORARIT TË VOTIMIT, PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR
KRYETAR NË BASHKINË HIMARË, TË DATËS 4 GUSHT 2024**

Në mbështetje të Dekretit të Presidentit nr. 244, datë 5.7.2024 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë Himarë”, dhe nenit 11, pika 1, neni 20, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

V E N D O S I:

1. Qendrat e votimit, ku do të zhvillohen zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 Gusht 2024, hapen në ora 07:00 dhe mbyllen në ora 19:00.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO

Kryetar

Arens ÇELA

Anëtar

Dritan ÇAKA

Anëtar

Helga VUKAJ

Anëtar

Muharrem ÇAKAJ

Anëtar

Data: __.__.2024 Nr:
Ora:



“Për miratimin e orarit të votimit, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar në Bashkinë Himarë, të datës 4 Gusht 2024”